

**Atraksionet turistike në komunat:Mitrovicë Jugore,Veriore,Leposavic,Zvecan,Zubin Potok**

Nr.	Emërtimi	Përshkrimi i atraksionit	Kategoria	Adresa	Komuna
1	Liçeni i Ujmanit	Liçeni i Ujmanit gjendet në veri të Republikës së Kosovës dhe është ndërtuar midis viteve 1979-1984. Liçeni i Ujmanit është liçe artificial më i madh në Kosovë me sipërfaqe prej 11.9 kilometra katrorë dhe 370 milionë kub ujë dhe ka një gjatësi prej 24 km dhe thellësi 105 m. Liçeni përveç që është njëri ndër atraksionet turistike të Kosovës, është edhe aset i rëndësishëm për prodhimin e energjisë me ujë si dhe nga ky liçe furnizohen Termocentrali i Obiliqit, Liçeni Batllavës dhe ai i Badofcit.	Atraksion artificial	Zubin Potok	Mitrovicë Jugore
2	Muzeu i Mitrovicës	Muzeu i Qytetit të Mitrovicës, është muzeu i dytë më i vjetër në Kosovë dhe njëherë muzeu i dytë më i pasur për nga llojlloshmëria, sasia e koleksioneve, për nga pasuritë e tashëgimisë kulturore të luajshme që i posedon. Muzeu ka pesë sektore të prezantuar me një kronologji kohore si Sektorin e fosileve, arkeologjisë, etnologjisë, historisë dhe multimedias.	Atraksion kulturor	Rruga "Shemsi Ahmeti" nr. 12 Mitrovicë	Mitrovicë Jugore
3	Kisha Sase/ Kisha e Shën Pjetrit	Kisha e Shën Pjetrit është monument sakral që për herë të parë përmendet në burimet arkivore perëndimore në vitin 1303.	Atraksion kulturor	Kolonia Angleze në Stantërg, Trepçë	Mitrovicë Jugore
4	Kështjella e Zveçanit	Kjo fortifikatë supozohet se u ndërtua gjatë periudhës së hershme Bizantine, gjatë periudhës së sundimit të Justinianit të I-rë. Është i njohur fakti se në atë kohë janë ndërtuar një dhe rindërtuar rreth 60 kështjella, duke e përfshirë edhe Kalanë e Zveçanit dhe Gjetitit - Rashan. Ky ndërtim është bërë me shkas që të jetë si një pararojë e Minijerës së Trepçës si dhe rrugëve të ndryshme që lidhin vendbanimet e vjetra si: Municipum DD, Trepçë-Vicianum-Novobërd, për shkakë të pozitës strategjike gjeografike që kishte. Sa i përket arkitekturës së kësaj kalaje, nga muret ka dëshmi së është rindërtuar disa herë, duke filluar nga periudha e pushtimit mesjetar bulgar, serb dhe osman. Kjo kala është braktisur në shekullin e XVIII. Sot ky lokalitet është në rrënoja. Ky monument është nën mbrojtje ligjore	Atraksion kulturor	Zveçan	Zveçan
5	Xhamia e Trepçës	Xhamia e Muslihudinit - Hyezin Hoxhës e njohur si Xhamia e Trepçës u ndërtua në shekullin e XIX. Xhamia e Trepçës e ushtrij funksionin e saj për çka ishte ndërtuar deri në fund të shek. XVII. Gjatë luftërave austro-osmane të viteve 1689-1690, kur austriaket kishin depërtuar në Trepçë, shumë fshatra dhe vendbanime ishin shkatërruar, fat të njëjti kishin edhe shumë objekte të ndryshme në mesin e tyre edhe Xhamia e Trepçës. Që nga shkatërrimi i saj e deri në ditët e sotme po thuhajse ka mbet nën mëshirën e kohës.	Atraksion kulturor	Trepçë, Shalë e Bajgorës	Mitrovicë Jugore
6	Hamami i Mitrovicës	Hamami i Qytetit gjendet në qendrën e qytetit të njohur si ish bërthama e vjetër e qytetit. Ky objekt u ndërtua në fund të shek. XVIII, nga Sylejman Beg Berisha dhe aneksi përcjellës u ndërtua nga nipi i tij Zejnullah Beg Berisha. Hamami i Qytetit është njëri ndër objektet më të ruajtura të periudhës osmane, objekt publik që funksionin e vet e kreu deri në vitin 1959, pastaj u shtetëzua nga pushteti i atëhershëm dhe për disa dekada u shfrytëzua si objekti për Muzeun dhe Arkivin e Qytetit të Mitrovicës. Në vitin 2005 kishte një ndërhyrje dhe restaurim	Atraksion kulturor	Rruga "Shemsi Ahmeti"	Mitrovicë Jugore
7	Xhamia e Vllahisë	Kjo fjalorë është e ndërtuar në fund të shekullit XVIII nga komuniteti i fshatit Vllahi në Shalë të Bajgorës nga mjeshtrit popullor të vendit. I takon të fazës së dytë të ndërtimit të xhamive në trojet shqiptare, ndërsa minarja i ndërtohet në shekullin e XX nga mjeshtrit e gurit ardhur nga Dibra. Kjo xhami kishte sallën e lutjeve me hajat të mbyllur dhe minaren, stili në të cilën u ndërtua ishte stil tradicional me çati katërrjeshë. Kjo xhami sikurse edhe shumë objekte të tjera u dëmtua në Luftën e fundit (1998-1999) në Kosovë, si dhe kishte disa ndërhyrje rekonstruimi me vullnet të komunitetit, që e ndryshuan gjendjen fillestare të këtij objekti. Xhamia në fjalë është e mbrojtur me ligj	Atraksion kulturor	Fshati Vllahi,	Mitrovicë Jugore
8	Shtëpia e Familjës Koroglu	Shtëpia e familjës Koroglu është shtëpi tipike qytetare me çardak. Sipas të dhënave shtëpia është ndërtuar rreth gjysmës së parë të shek. XIX nga familja Koroglu dhe kishte karakter të banimit. Ajo i takon tipit me çardak të mbyllur. E ngritur mbi bazën themelin me gurë, muret masive janë të muratuara në përdhësë nga guri, ndërsa muret e jashtme të konstruata nga brezat e drurit të mbythur me qerpiç formojnë konstruktin e shtëpisë në kat. Kjo shtëpi është e vetmja e llojit të tillë në qytetin e Mitrovicës, për nga vjetërsia dhe stili i ndërtimit dhe karakterit reprezentativ të familjës me standard të lart shoqëror. Kjo shtëpi ndodhet në qendër të qytetit të Mitrovicës si dhe është monument nën mbrojtje ligjore	Atraksion kulturor	Qendra e qytetit të Mitrovicës Jugore	Mitrovicë Jugore
9	Kompleksi i Kullave të Isa Boletinit	Kulla e familjës Boletini u ndërtuan gjatë shekullit të XIX si dhe që nga ajo kohë u shkatërruan dhe u rindërtuan disa here. Kulla e zjarrit është restauruar në vitin 2004 nga Ministria e Kulturës në Kosovë ndërsa Kulla e Burrave pjesërisht. Kulla paraqesin arkitekturën të shtëpive fortesa të shqiptarëve, të ndërtuara krejtësisht prej gurëve. Në planonë e brendshme të mureve rrethuese ishin të ngritura kullat: "Oda e Burrave" dhe "Shtëpia e zjarrit". Në obrorin e shkollës së tanishme ndodheshin objektet tjera përcjellëse (hambari, koshi, stalla e lopëve etj.) të kompleksit në fjalë e që tani ato nuk ekzistojnë më. Në Kullën e Zjarrit prezantohet një ekspozitë me objekte dhe materiale të familjës së Isa Boletinit. Ky monument gjendet në fshatin Boletin rreth 10 kilometra larg Mitrovicës si dhe është monument nën mbrojtje ligjore	Atraksion kulturor	Fshati Boletin	Zveçan
10	Teqet në Suhodoll	Junus Sabri efendiu e ndërtoi teqenë në shekullin e XX në Suhodoll të Poshtëm. Teqja qysh nga fillimi e deri sot, funksionon si objekt për realizimin e ritualeve religjioze dhe të mësimave të Melamet i/Melami.	Atraksion kulturor	Fshati Suhodoll	Mitrovicë Jugore
11	Hotel Jadran	Ndërtesa e Ish Hotel "Jadranit" ndodhet në qendër të qytetit të Mitrovicës. Ky objekt është ndërtuar në vitin 1928, nga arkitekt dhe puntor nga Budapesti. Për nga stili arkitektonik njihet me stilin austrohungarez dhe njëherit është njëri ndër objektet më përfaqësuese të shekullit XX në Mitrovicë. Përgjatë viteve '30-ta të shekullit XX ky hotel që posedonte sallë koncertesh, kinema dhe teatër, veglat muzikore si dhe pajisjet për shfaqjen e filmave të sjellura nga Amerika, shërbeu si një ndër hapësirat kyqë për zhvillimin e jetës kulturore në qytet.	Atraksion kulturor	Sheshi "Agim Hajrizi"	Mitrovicë Jugore
12	Shtëpia e Shoqatës së Gjetarëve	Në qendër të qytetit të Mitrovicës gjendet objekti i njohur si Shtëpia e Gjetarëve. Ndërtesa u ndërtua në vitet 1932-'33. Ndërtesa është e projektuar në stilin e arkitekturës së periudhës moderne euro perëndimore, stil ky që filloi të depërtojë edhe në këto treva në dekadën e dytë dhe të tretë të shek. XX. Ndërtesa ka pasur funksion të banimit. Ky objekt edhe sot e ruan origjinalitetin e vet. E vetmja dëshmi që ka mbetur nga humanisti hebraik Dr. Nehmin Shefajn, është shtëpia e tij, sot e njohur si "Shtëpia e Gjetarëve". Dr. Nehmin Shefajn kishte arritur në Kosovë në fillim të shek. XX nga Bashkimi Sovjetik në kuadër të misionit ndërkombëtar të Kryqit të Kuq. Ai ka kuruar shumë Mitrovicas dhe banorë të viseve të tjera të Kosovës nga epidemia e lisë. Në shkurt të vitit 1942. Dr. Shefajn burgoset nga nazistët dhe me 8 maj të po këtij viti pushkatohet në kampin famëkeq të Banjicës në Beograd.	Atraksion kulturor	Qendra e qytetit të Mitrovicës Jugore	Mitrovicë Jugore
13	Muzeu i Kristaleve	Në vitin 1964 themelohet Muzeu i Kristaleve të Mineraleve në të cilin janë të vendosura mbi 1300 eksponate të llojeve të ndryshme të kristaleve duke e shndërruar Muzeun në një objekt me rëndësi të madhe kombëtare për Kosovën si në aspekt të vlerave po ashtu edhe në aspekt turistik. Përveç kristaleve në Muze janë të ekspozuara edhe mjete të vjetra pune me të cilat janë shërbyer xehetarët në fillimet e punimeve në minierë. Përveç kristaleve nga miniera "Trepça", në Muze janë të ekspozuara edhe mbi 100 lloje të kristaleve nga vendet të ndryshme të botës si: Gjermania, Italia, Franca, Spanja, Brazil, të cilat Muzeu i ka marrë në këmbim me kristalet nga miniera e "Trepçës".	Atraksion kulturor/natyror	Trepçë, Shalë e Bajgorës	Mitrovicë Jugore
14	Përmendorja e Minatorëve	Përmendorja e Minatorëve është vepër arkitektonike e vetmja në Kosovë e akademikut Bogdan Bogdanovicit. Përmendorja është ndërtuar në formën e karocës për transportimin e xehes në teleferikun "Trepça" të vendosur në dy shtylla dhe i dedikohet viktimave të Luftës së Dytë Botërore. Si projekti u miratua të punohet në vitin 1959, dhe u finalizua në vitin 1973. Në hapësira publike të Mitrovicës përmendorja është kthyer në një ndër simbolikat më e mëdha të identitetit që lidhet me minatorin	Atraksion kulturor	Kodra e Minatorëve	Mitrovicë Veriore

15	Galeria Kadri Kadriu	Galeria Kadri Kadriu është themeluar në vitin 2020 nga Ministira e Kulturës së Kosovës. Kjo galeri i dedikohet jetës dhe veprës së artistit Kadri Kadriu, ku janë të prezantuar një ekspozitë me piktura dhe fotografi. Kjo galeri u ndërtua në kuadër të shtëpisë së tij të banimit ku jetonte autori, shtëpi që u shkatërrua Gjatë Luftës 1998-1999, ku dhe u vra nga forcat serbe	Atraksion kulturor	Suhodoll	Mitrovicë Jugore/veriore
16	Qendra e Kulturës	Kompleksi i objekteve të Qendrës së Kulturës në Mitrovicë filloi të ndërtohet në mars vitit 1979 dhe puna përfundoi në vitin 1984. Si objekt ishte projektuar nga arkitekti Tomislav Milovnovic, dhe për nga stili arkitektonik i takon stilit modernist.	Atraksion kulturor	Qendë e Mitrovicës Jugore	Mitrovicë Jugore
17	Ura e Ibrit	Ura e Ibrit gjithnjë ka shërbyer për qarkullimin e njerëzve dhe mallrave në të dyja anët e lumit Ibër. Një lloj ure në këtë vend mendohet të ketë ekzistuar qysh prej themelimit të këtij vendbanimi nga Gazi Isa Beu në shekullin XV. Sipas udhëpërshkruesit Evlia Çelebiu diku në shekullin e XVII hasim përshkrim për Urën e Ibrit si lidhje në mes të Mitrovicës dhe Pazarit të Ri. Sipas dokumenteve osmane përmendet se kishte rindërtim disa herash në këtë urë, për shkak të rëndësisë së saj të ndërlidhjes së komuniteteve. Në historinë më të re është e dëshmuar se në vitin 1933 është rindërtuar prapë por nga materiali i metalit, si dhe në vitin 1974 është zëvendësuar me materiale të betonit. Ura e Ibrit që nga viti 1999 është kthyer në simbolikën e ndarjes etnike të qytetit, duke e ndarë Mintrovicën në dy vija etnike. Përgjatë vitet 2002 kishte edhe rindërtim nga KFOR-i Francez si dhe në vitete e fundit kishte rivitalizim nga fondet e Bashkimit Evropian.	Atraksion artificial	Qender e qytetit të Mitrovicë	Mitrovicë Jugore dhe Veriore
18	Liçeni Akumulues	Liçeni i Mitrovicës është një liqe artificial i cili ka gjatësi prej rreth 1,8 kilometrash, gjërsi deri në 150 metra dhe thellësi deri në 4 metra. Liçeni i Mitrovicës shtrihet në hapësirën përgjatë rrjedhës së lumit Ibër, në mes Mitrovicës dhe fshatrave: Suhodolli i Poshtëm, Suhodolli i Epërm, Zhabari i Poshtëm e deri në Gushacë e Vinarçë të Poshtme	Atraksion artificial	Fshati Suhodoll	Mitrovicë Jugore
19	Ujvara e Trepçës	Ujvara e Trepçës është atraksion natyror turistik i krijuar nga rrjedha natyrore e lumit Trepça. Ujvara ndodhet në afërsi të Trepçës.	Atraksion kulturor	Fshati Trepçë	Mitrovicë Jugore
20	Malet e Shalës së Bajgorës	Një ndër atraksionet kryesore natyrore të regjionit të Mitrovicës është malësia e Shalës së Bajgorës, që është trevë malore që shtrihet mes luginës së Ibrit dhe Llapit në rrëzat e Kopaonikut. Treva e Shalës së Bajgorës përfshinë një sipërfaqe rreth 433 km <sup>2</sup> dhe përbëhet prej 54 vendbanimeve. Emri Shalë e Bajgorës ka mbetur nga fisi Shalë dhe fshati qendror Bajgorë, pasi vendbanimi Bajgorë është territorialisht vendbanimi më i madh i kësaj treve. Kjo hapësirë malore gjendet rreth minierës së Stantërgut, ku nxirret xehja e plumbit dhe e zinkut. Shala e Bajgorës është pjesë e Kosovës së Veriut, pranë së cilës ndodhet edhe Miniera e Trepçës.	Atraksion kulturor	Shala e Bajgorës	Mitrovicë Jugore
21	Parku i Erës në Shalë të Bajgorës	Parku i Erës është investim privat që ndodhet në fshatin Bajgor. Si investim ka për qëllim të rrisë prodhimin e energjisë alternative të rrymës për Kosovë. Dhe si investim është kthyer poashtu në atraksion turistik që gërshetohet me pamjet pitoreske të asaj ane.	Atraksion natyror/artificial	Shala e Bajgorës	Mitrovicë Jugore
22	Kroni i Akullit	Në listën e atraksioneve të rralla natyrore në Kosovë, bënë pjesë Kroni i Akullit që ndodhet në majën e malit Majdan. Që karakterizohet me fenomenin e akullit gjatë katër stinëve të vitit.	Atraksion kulturor	Fshati Rahovë (Mali Majdan)	Mitrovicë Jugore
23	Gjyteti në Rashan	Kalaja ndodhet në afërsi të fshatit Rshan, në rajonin jugor të Shalës së Bajgorës me distancë rreth 10 km larg qytetit të Mitrovicës. Mendohet se kjo Kala së bashku me Kalan e Zveçanit u ndërtuan gjatë periudhës së perandorit bizantin me prejardhje dardane Justiniani i Madh. Gjatë periudhës së sundimit të Justinianit, teritori i Dardanisë u fortifikua me afër gjashtëdhjetë kala, disa prej të cilave u ndërtuan si dhe disa tjera u rindërtuan. Vlen të veçohet së Kalaja e Rshanit-Gjytetit së bashku me Kalanë e Zveçanit u ndërtuan për ta mbrojtur minijerën Trepça	Atraksion kulturor	Fshati Rshan, Shalë e Bajgorës	Mitrovicë Jugore
24	Municipum DD	Ky lokalitet arkeologjik i takon shekujve II-III dhe ndodhet në teritorin e Kosovës Veriore. Në kohën kur u ndërtua ky vendbanim i tipit urban, ishte zona më e rëndësishme administrative në Provincen e atëhershme romake të Dardanisë, edhe pse nga gjurmët vëreth ekzistenca e një vendbanimi parahistorik në të cilën u ndërtua më vonë Municipumi DD.	Atraksion kulturor	Albanik	Leposavic
25	Trashëgimia Industriale	Fabrikat e Fosfateve kimike, e Akumulatorëve dhe Elektroliza e zinkut, kanë një mori objekteve identifikuese me veprimtarin e industriale, që njëherit janë ndërtuar mbi lokalitetin arkeologjik të periudhës së neolitit (në Fafos të Mitrovicës). Së bashku si tërësi e objekteve përbën një atraksion të rrallë turistik.	Atraksion kulturor	Mitrovicë Jugore	Mitrovicë Jugore
26	Manastiri i Sokolicës	Manastiri i Sokolicës gjendet në shpatet e kodrës së Sokolicës, 10 km në lindje të Zveçanit, në afërsi të Mitrovicës. Manastiri i Sokolicës është dedikuar për nderin e Virgjërshës së Shenjtë. Supozohet se kisha e manastirit është ndërtuar në periudhën midis shekullit XIV dhe XV nga Musa /dhëndri i Car L Lazarit dhe babai i vëllezërve Musiq.	Atraksion kulturor	Sokolicë	Zveçan
27	Kisha ortodokse e Shën Lazarit	Kisha ortodokse e Shën Lazarit ndërtuar në shekullin XIV në qendër të katundit Banjë (sipas të dhënave serbe).	Atraksion kulturor	Banjë	Zubin Potok
28	Kisha ortodokse e së dielës së shenjtë	Kisha ortodokse e së dielës së shenjtë (Shën Dielës), ndërtuar në shekullin e XIII dhe shkatërruar më 1941 në Bërnjakë	Atraksion kulturor	Bërnjakë	Zubin Potok
29	Kisha ortodokse e virgjër në Jagnjenicë	Kisha ortodokse e virgjër në Jagnjenicë ndërtuar në shekullin XIV, shkatërruar në shekullin XVI, tani është duke u rindërtuar.	Atraksion kulturor	Jagnjenicë	Zubin Potok
30	Banja/burimi mineral	Banja/burimi mineral, në Venicë	Atraksion natyral	Venicë	Leposaviq (Albanik)
31	Gjashhtë kishat	Në teritorin e komunës janë gjashhtë kisha, njëra nga të cilat është proklamuar si bazilikë.	Atraksion kulturor	Leposaviq (Albanik)	Leposaviq (Albanik)